



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu

Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin e turizmit “ITB BERLIN” në Berlin/Gjermani

Me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) promovon bizneset e sektorit të turizmit në panairin ndërkombëtar “ITB BERLIN” në Berlin/Gjermani datë 05.03.2024-07.03.2024.

Paraqitja shtetërore organizohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përkatësisht Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e shtandit, regjistrimin e shtatë (7) kompanive pjesëmarrëse [dy (2) prej tyre startup (e themeluar 1-5 vitet e fundit)], shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Shprehjet e interesimit të dërguara deri me datë 20.02.2024 dhe vetëm aplikacionet e plotësuara tërësisht mund të konsiderohen për vlerësim.

1. Dokumentet e domosdoshme për aplikim:

- 1.1 Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
- 1.2 Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
- 1.3 Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njëren prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
- 1.4 Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;

- 1.5 Vërtetimin nga Gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (jo më i vjetër se 30 ditë)
- 1.6 Deklaratën nën betim;
- 1.7 Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës (Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
- 1.8 Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj.

Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e veçanta të listuara më poshtë.

Shtatë (7) Operator turistikë pjesëmarrës do të përzgjidhen sipas kriterëve të veçanta si në vijim dhe rangimit të pikëve:

- 1.1. Produktet turistike inbound që do të ju ofrohen turistëve gjatë vitit 2024, maksimum tridhjetë (30) pikë: (2) pikë për një (1) produkt turistik inbound, katër (4) pikë për dy produkte turistike inbound, gjashtë (6) pikë për tri (3) produkte turistike inbound, tetë (8) pikë për katër (4) produkte turistike inbound dhe tridhjetë (30) pikë për pesë (5) e më shumë produkte turistike inbound;
- 1.2. Njohuria e gjuhëve të huaja dhe aftësi prezantuese të përfaqësuesve të subjektit aplikues, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: gjuhë Angleze gjashtë (6) pikë, gjuhë Gjermane gjashtë (6) pikë dhe gjuhët tjera tre (3) pikë;
- 1.3. Materiale promovuese të subjektit aplikues në gjuhët e huaja, maksimum pesëmbëdhjetë (15) pikë kumulative: në gjuhën Angleze gjashtë (6) pikë, në gjuhën Gjermane gjashtë (6) pikë dhe tre (3) pikë në gjuhë tjera evropiane;
- 1.4. Aktiviteti primar turistik i subjektit, maksimum dhjetë (10) pikë: agjencion turistik katër (4) pikë dhe tour operatorë dhjetë (10) pikë;

Më 12.02.2024, në ora 10:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha kompanitë vendore të cilat promovojnë potencialet turistike të Republikës së Kosovës.

Përparësi në përzgjedhje do të kenë subjektet të cilat nuk kanë marr pjesë në panair ndërkombëtar në dy vitet e fundit të organizuara nga MINT/KIESA.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë në mënyrë elektronike më së largu deri më 20.02.2024 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësi për shprehje të interesit mund të merren në KIESA-MINT apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën Export.Kiesa@rks-gov.net.